



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

Prishtinë, 09 shtator 2022

Vendimi Nr. 32/22

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,26,27 dhe 55 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e datës 09.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjes “Banka Ekonomike Sh.A” (blerësi) për blerjen e 100 % të aksioneve të Kompanisë së Sigurimeve “Siguria Sh. A” (shitësi).

Banka Ekonomike Sh.A është shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë PN, Republika e Kosovës, me numër të biznesit 810485864.

Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.A është shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë rr. “Qamil Hoxha”, nr. 51, Republika e Kosovës me numër të regjistrimit të biznesit 810495102.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 € (njëqind euro) dhe për Vendimin për lejimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë Euro).

**Arsyetim**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 26.07.2021, ka pranuar kërkesë me nr. prot. 201/22-01/H, lidhur me njoftimin për Përqendrimin e ndërmarrjeve përmes parashtruesit të kërkesës z. Etnik Maloku, përfaqësues ligjor nga Banka Ekonomike Sh.A, për blerje nga Banka Ekonomike Sh.A të 100% të aksioneve të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.A.

**Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i lëndës/dokumentacionit
2. Njoftimi për qendrimin në ueb faqën e AKK-së, më dt. 03.08.2022
3. Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar më datë 10.08.2022.

#### 4. Dokumentacioni i nevojshëm për qëllimin e njoftimit të Përqendrimit

Kërkesa për Përqëndrim është bazuar në marrëveshjen e palëve të datës 17.05.2022, palët kanë nënshkruar marrëveshje me të cilën Banka Ekonomike do të blejë 100% të aksioneve të Kompanisë së Sigurimeve të Siguria Sh.A.

#### **Baza juridike;**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës (qarkullimi nga pasqyrat financiare), palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Së paku dy pjesëmarrës në përqëndrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm.
- b) Kompania Banka Ekonomike dhe Siguria janë ndërmarrje me kapital vendor, pra janë të regjistruara në Republikën e Kosovës (tregu i brendshëm).
- c) Kontrata e Shitblerjes ndërmjet palëve, datë 17.05.2022
- d) Kërkesa për përqëndrim është bërë për arsye se blerësi dhe shitësi janë prezent dhe kryejnë aktivitetet e tyre në Republikën e Kosovës.

#### **Vlerësimi i Konkurrencës - Tregu Relevant**

*Tregu i produktit* – shërbime bankare.

*Tregu gjeografik* – Tregu gjeografik përkufizohet si territori i Republikës së Kosovës.

#### **Tregjet e Prekura**

Transaksioni, nuk krijon tregje të prekura, pasi që Banka Ekonomike dhe Siguria Sh.A nuk janë në treg të njëjtë të produktit, që do të thotë në mes tyre nuk ka marrëveshje vertikale dhe horizontale, pra asnjëri nga pjesëmarrësit nuk vepron në tregun në të cilin rëniat dhe ngritjet në raport me tregun në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër i përqendrimit, ndërsa tregu përkatës gjeografik është vetëm tregu Kosovës ku targeti dhe blerësi janë aktiv, që në këtë rast kemi të bëjmë me një përqëndrim konglomerat.

#### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se blerësi dhe shitësi janë të regjistruara përkatësisht aktivitetin e tyre e kanë në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Duke parë që struktura e Bankës Ekonomike Sh.A, si kompani blerëse është vetëm 7% e tregut, transaksioni nuk do të shkaktoj çrregullim të konkurrencës, apo të ndikoj në krijimin dhe forcimin e pozitës dominuese në treg. Pala blerëse do ta ruaj pozicionin aktual në tregun përkatës.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Komisioni**

**Neime Binaku-Isufi**  
Kryetare



**Kaltrina Sela**  
Zv. Kryetare

**Nafije Osdatuaj**  
Anëtare